



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL

PËR

BASHKIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT DHE ZHVILLIMIN E TYRE NË NJË PROCEDURË TË NDARË NË LOTE

Sot, më datë ____/____/2026, pranë autoritetit kontraktor Bashkia Himarë, u mbajt ky procesverbal në lidhje me nevojën për bashkimin e dy procedurave të prokurimit të planifikuara më vete dhe zhvillimin e tyre në kuadër të një procedure të vetme prokurimi, të ndarë në dy lote.

1. Procedurat e planifikuara

Në regjistrin/parashikimin e prokurimeve të Autoritetit/Entit Kontraktor janë parashikuar procedurat me objekt:

1. “**Rikonstruksioni i urës së varur Kallarë**”, me fond limit **41,666,667** (Dyzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë lekë) **pa TVSH**;
2. “**Rikonstruksioni i urës në hyrje të fshatit Kallarë**”, me fond limit **23,227,930** (njetzet e tre milion e dyqinde e njetzet e shtatë mijë e nentëqinde e tridhjetë lekë) **pa TVSH**.

Pas shqyrtimit të nevojave, natyrës së mallrave/shërbimeve/punëve që kërkohen, specifikimeve teknike, afateve të realizimit dhe mënyrës së administrimit të procedurave, është vlerësuar e përshtatshme që këto dy prokurime të zhvillohen nëpërmjet një procedure të vetme prokurimi, të ndarë në dy lote.

2. Arsyeimi i bashkimit

Bashkimi i dy procedurave në një procedurë të vetme të ndarë në lote bëhet me qëllim:

- Rritjen e eficiencës në zhvillimin dhe administrimin e procesit të prokurimit;
- Shmangien e zhvillimit të procedurave të veçanta për nevoja që mund të prokurohen në kuadër të së njëjtës procedure;
- Garantimin e përdorimit me eficiencë të fondeve publike;
- Ruajtjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke mundësuar pjesëmarrjen dhe paraqitjen e ofertave sipas loteve;
- Unifikimin e afateve dhe administrimin më të efektshëm të procesit të prokurimit.

Ndarja në lote ruan individualitetin e secilit objekt dhe u mundëson operatorëve ekonomikë të paraqesin ofertë për një ose për të dy lotet, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në rastin konkret jemi në kushtet ku lloji i procedurës nuk ndryshon, edhe në variantin e dy procedurave më vete do të kishim “Procedurë të hapur”, edhe në rastin e bashkimit do të kemi “Procedurë të hapur”.

3. Struktura e procedurës së re

Për sa më sipër, propozohet që procedurat e mësipërme të bashkohen dhe të zhvillohen si një procedurë e vetme me objekt:

“Rikonstruksioni i urave në fshatin Kallarat

LOTI 1 – “Rikonstruksioni i urës së varur Kallarat” me fond limit: **41,666,667** (Dyzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë lekë) **pa TVSH.**

LOTI 2 – “Rikonstruksioni i urës në hyrje të fshatit Kallarat” me fondi limit: **23,227,930** (njetete e tre milion e dyqinde e njetete e shtate mije e nenteqinde e tridhjetë lekë) **pa TVSH.**

Fondi limit total i procedurës: 64,894,597 (Gjashtëdhjetë e katër milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë) pa tvsh.

Kriteret e kualifikimit, specifikimet teknike, sasitë, fondi limit dhe kërkesat e tjera përkatëse do të përcaktohen për secilin lot në dokumentet e procedurës së prokurimit, në përputhje me natyrën dhe objektin përkatës.

4. Përfundimi

Në përfundim, duke marrë në konsideratë sa më sipër, vlerësohet e arsyeshme që procedurat:

- **“Rikonstruksioni i urës së varur Kallarat”**; dhe
- **“Rikonstruksioni i urës në hyrje të fshatit Kallarat”**

Të mos zhvillohen si dy procedura të veçanta, por të bashkohen në një procedurë të vetme prokurimi, të ndarë në dy lote, duke kryer njëkohësisht ndryshimet/pasqyrimet përkatëse në dokumentacionin dhe planifikimin e prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky procesverbal hartohet për të dokumentuar dhe argumentuar bashkimin e procedurave dhe vijimin e veprimeve të mëtejshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT